

URDHËR
Nr. 572, datë 30.10.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; të shkronjës “r”, të nenit 10, të vendimit nr. 124, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kapitullit 2, “Rregullore e përshkrimeve të punës”; të pikës 4 dhe të nënkapitullit III “Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm”; të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, znj. Brunilda Mene, me detyrë zëvendës drejtor i përgjithshëm, për ndjekjen e mbarëvajtjes së punës së Drejtorisë së Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe objektivave institucionale.

2. Drejtoria e Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të jenë në varësi direkte të znj. Brunilda Mene, zëvendës drejtor i përgjithshëm.

3. Zëvendës drejtori i përgjithshëm të mbikëqyrë dhe të nënshkruajë aktet administrative të këtyre drejtorive, në lidhje me zbatimin e detyrave të përcaktuara në rregulloren “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës së Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, për Drejtorinë e Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Brunilda Mene, zëvendës drejtor i përgjithshëm si dhe të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Anila Denaj